

BULETINI INFORMATIV



Gjatë muajit dhjetor, ERE ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë së saj rregullatore dhe vendimmarrëse në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në këtë përmbledhje mujore do të gjeni informacion mbi licencimet e reja, publikimet, të dhënat e tregut, çmimet e shitjes së energjisë elektrike si dhe dokumentet/aktet rregullatore që ndodhen në proces konsultimi publik.

Synimi ynë mbetet garantimi i transparencës, rritja e eficiencës dhe mbështetja e zhvillimit të tregut të energjisë në vend.

Për më shumë detaje, vendimet dhe dokumentet e plota mund t'i shfletoni në faqen tonë zyrtare: www.ere.gov.al

Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit dhjetor

Gjatë muajit dhjetor 2025, Bordi i ERE ka zhvilluar 5 mbledhje vendimmarrëse për të cilat është bërë njoftimi të paktën 24 orë përpara edhe në rrjetet sociale të institucionit, duke ftuar të gjitha palët e interesit të ndjekin mbledhjen online. Në këto mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan 37 vendime, që përfshijnë: çmimet dhe tarifat e ndryshme që do të aplikohen gjatë vitit 2026 në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror; fillimin e procedurave të reja të licencimit; autorizime; pezullim apo zgjatje të afateve vendimmarrëse; rishikimin e akteve rregullatore si dhe fillimin e procedurave për rishikimin e rregulloreve të miratuara më parë, të cilat aktualisht janë objekt i konsultimit publik. Një përmbledhje e vendimmarjes së Bordit është publikuar pas çdo mbledhje në rrjetet sociale. Ndërsa vendimet e plota gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ERE-s në kategorinë vendimet si dhe në Fletoren Zyrtare.

Njoftim

Gjatë muajit dhjetor, nëpërmjet faqes zyrtare të ERE-s si dhe rrjeteve sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, janë njoftuar të gjithë klientët e lidhur në nivelin e tensionit 6 kV, të cilët sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", u përfundonte afati i furnizimit nga FMF (FSHU sh.a.), nga data 1 janar 2026. Këto klientë kanë të drejtë të furnizohen nëpërmjet furnizuesve të licencuar që ofrojnë këtë shërbim. Në faqen e ERE-s www.ere.gov.al, në platformën e krahasimit të çmimeve PCT (Price Comparison Tool), e aksesueshme nëpërmjet linkut <https://pct.ere.gov.al/>, mund të kërkojnë dhe gjenden ofertat e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë konsumatorët e energjisë që nuk mund të kontraktjnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin aktual, mund të përfitojnë të drejtën e furnizimit për një periudhë të kufizuar kohe (60 ditë) nga "Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", aktivitet i cili aktualisht ushtrohet nga FSHU sh.a.

Gjithashtu, në çdo kohë këto klientë kanë të drejtë për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, si një e drejtë e garantuar me ligj.

BULETINI INFORMATIV

DHJETOR

2025



Procedura licencimi të filluara gjatë muajit dhjetor

Gjatë muajit dhjetor, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "DEVOLL HYDROPOWER" shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Në përputhje me "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, ERE ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, njoftimin për marrjen e objeksioneve para vendimmarrjes respektive të rinovimit ose jo.

Raportet e pajtueshmërisë me rregullat e ndarjes së operatorëve

Në mbledhjen e datës 18 dhjetor u shqyrtuan raportet e pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) si dhe të "TRANS ADRIATIC PIPELINE AG", për vitin 2024.

Autorizime për garanci financiare

- Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj "Banka OTP Albania" sh.a., për shoqërinë "AGE ERZEN sh.p.k, licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.07.2024, nga HEC "Hekali" me kapacitet prodhues 1.94 MW.
- Bordi i ERE-s vendosi të shfuqizojë vendimin nr. 216, datë 18.09.2025 për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "D I E Z E L A" sh.p.k., të licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.01.2020, i ndryshuar, nga HEC "Ljusa" me kapacitet të instaluar 1.98 MW.
- Bordi i ERE-s miratoi kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse "Banka Amerikane e Investimeve" sh.a., për shoqërinë "GREEN ENERGY" sh.p.k, licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 09.06.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet 2 MW.
- Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për marrjen e autorizimit për vendosje kolateral asetet fikse si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj Raiffeisen Bank sh.a, për shoqërinë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.09.2022, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për Centralin Fotovoltai me kapacitet 10 MW.

BULETINI INFORMATIV

Akte rregullatore të miratuara apo për të cilat kanë filluar procedurat gjatë muajit dhjetor.

Gjatë muajit dhjetor ka filluar procedura edhe për rishikimin e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i aplikimeve të paraqitura, sipas llojit të licencës, u vlerësua e nevojshme fillimi i procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në rregullat aktuale.

Ndryshimet e propozuara në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, janë të nevojshme në kuadër të përmirësimit të saj dhe të saktësisimit/qartësisimit të dokumentacionit, afateve dhe procedurave përkatëse sipas llojit të aplikimit përfshirë udhëzuesët në lidhje me dokumentacionin sipas llojit të aplikimit.

Gjithashtu, gjatë muajit dhjetor, Bordi i ERE-s ka vendosur pezullimin e afateve të vendimmarrjes, deri në paraqitjen e plotë të dokumentacionit të kërkuar, për procedurat e licencimit të shoqërive si më poshtë:

- "ELENERGJI" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Bushtrica 1", me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
- "BUSHTRICA 2017" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Bushtrica 2", me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.

Vendime të tjera

Bordi i ERE-s gjatë këtij muaji, ka vendosur të refuzojë kërkesën e shoqërisë "GET Solar Solution" shpk, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 24 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3164, fshati Rehovë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë, për shkak të mosplotësimit nga ana e shoqërisë të dokumentacionit të kërkuar nga rregullorja.

Bordi i ERE-s ka vendosur të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e bordit nr. 148, datë 08.07.2025, "Mbi pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "SunPro" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike", i ndryshuar dhe të zgjasë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes për aplikimin e shoqërisë, me qëllim zhvillimin e korrespondencës me OST sh.a., për pikën e lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit dhe me vetë shoqërinë në lidhje me afatet e vënies në punë të centralit.

Gjatë muajit dhjetor, Bordi i ERE-s ka vendosur të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë "PROSOL" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, me qëllim depozitimin nga ana e shoqërisë të informacionit/dokumentacionit përkatës në lidhje me sqarimin e kapacitetit të instaluar të centralit.

BULETINI INFORMATIV

DHJETOR

2025



Raportime të të licensuarve

Gjate muajit dhjetor, me qëllim disiplinimin e praktikës së raportimit, rritjen e transparencës dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit të zbatimit të kushteve të licencës, (pika 2.5), në mbledhjen e datës 23 dhjetor 2025 ndër të tjera u miratua data 31 janar e çdo viti si afati i fundit për raportimin pranë ERE nga subjektet e licencuara, lidhur me sigurimin sipas përcaktimeve të kontratës për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve gjeneruese të energjisë elektrike, si dhe në përputhje me kushtet e licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

Në mbledhjen e Bordit të ERE-s, datë 29.12.2025, janë miratuar gjithashtu:

- Kodi i Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen;
- Udhëzuesi mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

Të dy këto akte kanë qënë të publikuara për konsultim publik në faqen zyrtare të ERE-s sipas afateve ligjore. Miratimi i këtyre akteve plotëson më tej kuadrin rregullator për sigurinë, qëndrueshmërinë dhe funksionimin e koordinuar të sistemit elektroenergjetik, në përputhje me standardet evropiane (kodet evropiane të rrjetit ENTSO-E) dhe detyrimet e Shqipërisë për harmonizim me acquis të BE-së në sektorin e energjisë.

Pas takimit të zhvilluar me grupet e interesit shqyrtimit të kërkesave të paraqitura prej tyre, në kushtet kur “KESH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. kanë bërë me dije afate konkrete për përgatitjet teknike përkatëse gjatë vitit 2026, u miratua detyrimi për implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit, deri më 30.06.2026. Ky vendim reflekton nevojën për të krijuar kështu hapësirën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve teknike dhe realizimin e kalimit të sinkronizuar në rezolucion 15-minutësh.

Për sa i përket sektorit të gazit natyror, gjatë muajit dhjetor Bordi i ERE-s shqyrtoi dhe miratoi gjithashtu:

- Lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a.”, për vitin 2026.
- Kërkesën e Albgaz sh.a. “Mbi shtyrjen e procedurës së miratimit të Planit 10 – vjeçar të zhvillimit të rrjetit” deri në muajin dhjetor 2026.

REMIT

Në përputhje me “Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126, datë 17.05.2021 si dhe Ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, edhe gjatë muajit dhjetor ERE ka vijuar me përditësimin e të dhënave mbi regjistrimin e Pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (regjistri REMIT). Për vitin 2025 numri total i shoqërive të regjistruar në regjister është 87. Përgjatë muajit dhjetor është regjistruar vetëm 1 subjekt, respektivisht shoqëria “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k. Ky regjistër, gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen e ERE-s në linkun <https://remit.ere.gov.al/>.

BULETINI INFORMATIV

DHJETOR

2025

MBROJTJA E KONSUMATORIT

Fillimi i procedurave për rishikimin e treguesit të kritereve standarde të cilësisë së shërbimit

Në dhjetor, Bordi i ERE vendosi fillimin e procedurës për ndryshimin e disa treguesve të kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes. Kjo iniciativë synon rritjen e standardeve dhe përmirësimin e performancës së furnizuesve, duke garantuar një shërbim më cilësor për konsumatorët. Procedura ka kaluar në fazën e konsultimit publik para miratimit final, duke u mundësuar të gjitha palëve të interesuara të japin mendimin e tyre.

Procedura për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

Gjatë muajit, ERE zhvilloi procedurën për përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit. Procedura u zhvillua sipas kritereve të paracaktuara në rregulloren e miratuar nga ERE dhe u mbyll pa identifikimin e fituesit duke qënë se në këtë konkurrim u paraqit vetëm një aplikant, ç'ka e bën procedurën e përzgjedhjes të pamundur në kuptim të parashikimeve të rregullores së përzgjedhjes së FMF. Aktualisht shërbimi i furnizimit të mundësisë së fundit, vijon të ofrohet nga FSHU sha.

Mbi kërkesën e AAES për derogim të pjesshëm

ERE adresoi kërkesën e Shoqatës së Furnizuesve të Energjisë elektrike (AAES) për derogim të pjesshëm të dispozitave të "Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit", të miratuar me Vendimin nr. 23/2022 të Bordit të ERE. ERE, theksoi se rregullorja mbetet në fuqi sipas kushteve të përcaktuara në vendim, duke ruajtur kuadrin ligjor dhe standardet e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorit.

ALPEX

Çmimi mesatar ditor klerues i bursës "ALPEX" sh.a për muajin nëntor ka qënë 108.78 €/MWh ndërkohë që volumet mesatare ditore janë përllëgoaritur rreth 3,971 MWh. Për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë, oferta në blerje për muajin nëntor ishte 120,770.51 MWh, ndërkohë, oferta në shitje ka qënë 209,890.98. Për bashkimin e tregut Shqipëri - Kosovë, oferta në blerje për muajin nëntor ishte 278,902.47 MWh, ndërkohë oferta në shitje ka qënë 346,828.84 MWh.

Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit dhjetor është përditësuar informacioni në webin e ERE-s www.ere.gov.al dhe rrjetet sociale me vendime, njoftime të mbledhjeve, njoftime mbi aplikime të reja për licencim si dhe çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2025. Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))
- Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))

Gjatë muajit dhjetor kanë qënë në fazë konsultimi materialet:

- "Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike";
- Kodi i Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen (material në konsultim që prej datës 17.11.2025).

Dhe aktualisht janë në konsultim apo në procedurë shqyrtimi materialet e mëposhtme të cilat mund ti shfletoni në [linkun https://ere.gov.al/sq/publikime/konsultime](https://ere.gov.al/sq/publikime/konsultime):

- Pozicioni i Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike mbi Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike
- Draft - Ndryshimet e propozuara në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".
- Kërkesa e shoqërisë ALPEX sh.a. për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitet 2026, 2027 dhe 2028.

BULETINI INFORMATIV



Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit

Në mbledhjen e datës 12.12.2025 Bordi i ERE-s miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2025, në vlerën 14.52 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Ky çmim rezulton më i ulët krahasuar me muajin tetor 2025, i cili ishte 16.60 lekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, kostot e rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhatjen është kosto e energjisë së blerë.

Për muajin nëntor 2025, kosto mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar në vlerën 10.74 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 113.51 MWh. Ndërkohë, për muajin tetor 2025, kosto përkatëse ka rezultuar 12.76 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 119.64 MWh. Në terma krahasues, kosto e blerjes së energjisë për muajin nëntor është ulur rreth 15.8% në raport me muajin tetor, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35k V është ulur rreth 5%.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, siç është miratuar nga ERE në fillim të vitit 2025. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbyshje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Tarifat e shpërndarjes së energjisë elektrike

Në mbledhjen e datës 12.12.2025 Bordi i ERE-s me vendimin nr. 312 vendosi mbi lënien në fuqi deri me datë 30 prill 2026 të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, përkatësisht:

- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV - 1.55 Lekë/Kwh
- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.6 - 20 kV - 3.99 Lekë/Kwh
- Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV - 6.42 Lekë/Kwh
- Çmimi i aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive prej 1.92 lekë/kVarh
- Tarifa fikse e shërbimit për leximin "zero" prej 200 lekë/muaj

Për qëllime të vlerësimit të mjaftueshmërisë së të ardhurave të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe në mungesë të një aplikimi zyrtar.

Për një vlerësim të plotë dhe të drejtë të komponentëve të të ardhurave, ERE ka vlerësuar që tarifat aktuale të shpërndarjes të vijnë në fuqi deri më 30.04.2026. Gjatë kësaj periudhe, OSSH sh.a. duhet të dorëzojë në ERE pasqyrat financiare të certifikuara për vitet 2024 dhe 2025, si dhe të përmbyshë kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

BULETINI INFORMATIV

DHJETOR

2025

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2026

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 322, datë 15.12.2025 vendosi mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 10, datë 08.01.2025 deri më 31.12.2026 për çmimet me pakicë për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal si dhe të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 255, datë 15.10.2025 deri më 31.12.2026 për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW të lidhura në nivelin e tensionit 04 kV.

TARIFAT DHE ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR PËR VITIN 2026

SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Përshkrimi	Nr. I VENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi për periudhën 01.01.2026 - 31.12.2026	Nr. 324, Datë 15.12.2025	10 Lekë/ kWh
Tarifat për periudhën 1 Janar 2025 - 31 Dhjetor 2027		
Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike	Nr. 279, Datë 16.12.2024	0.85 Lekë/kWh
Tarifat për periudhën 1 Janar 2026 - 30 Prill 2026		
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	Nr. 312, Datë 12.12.2025	1.55 Lekë/kWh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20/10/6 kV	Nr. 312, Datë 12.12.2025	3.99 Lekë/kWh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 04 kV	Nr. 312, Datë 12.12.2025	6.42 Lekë/kWh
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Lekë/Muaj)	Nr. 312, Datë 12.12.2025	200 Lekë
Çmimi i aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive	Nr. 312, Datë 12.12.2025	1.92 Lekë/kVArh

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL, MIRATUARA ME VENDIMIN NR.322, DATË 15.12.2025, PËR PERIUDHËN 1 JANAR- 31 DHJETOR 2026

TË

Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive (Lekë/kWh)	**Çmimi i energjisë aktive në orar pik (Lekë/kWh)
Klientë të lidhur në 0.4 kV	14 Lekë/ kWh	16.1 Lekë/ kWh
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV:		
Kategoria I - Furra buke/ Prodhim mielli në 0.4 kV	7.6 Lekë/ kWh	8.74 Lekë/kWh
Kategoria II - Furrë buke, produkte mielli shoqëruese dhe pastigjeri në 0.4 kV	9.5 Lekë/kWh	10.93 Lekë/kWh
Kategoria III - Furrë buke, produkte mielli shoqëruese dhe pastigjeri, shërbim kafe në 0.4 kV	12 Lekë/kWh	13.80 Lekë/kWh
Objekte kulti dhe bashkësi fetare	9.5 Lekë/kWh	
Familjarë:		
Konsumatorët familjarë që konsumojnë deri në 700 kwh në muaj	8.5 Lekë/kWh	
Konsumatorët familjarë që konsumojnë më shumë se 700 kwh në muaj	* 9.5 Lekë/kWh	
Çmimi për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (Ndriçim shkalle, pompë, ashensor,)	9.5 Lekë/kWh	

* Për konsumatorët familjarë të cilët konsumojnë 701 kWh në muaj e më tej, çmimi i energjisë elektrike do të jetë 9.5 lekë/kWh për të gjithë sasinë e konsumuar gjatë një muaji

ÇMIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KARIKIMIN E MAKINAVE ELEKTRIKE NË PIKAT/STACIONET E KARIKIMIT ME FUQI TË INSTALUAR MBI 11 kW TË LIDHURA NË NIVELIN E TENSIONIT 04 kV TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR.322, DATË 15.12.2025, PËR PERIUDHËN 1 JANAR - 31 DHJETOR 2026

Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive lekë/kWh	**Çmimi i energjisë aktive në pik lekë/kWh
Pika/stacione karikimi të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11kW	22 lekë/kWh	25.3 lekë/kWh

**Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është:

Për periudhën 1 Nëntor -31 Mars nga ora 18:00 - 22:00

Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 - 23:00

SEKTORI I GAZIT NATYROR

Përshkrimi	NR. I VENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Tarifa e shërbimit të transmetimit të Gazit Natyror	Nr. 313, Datë 12.12.2025	28 Lekë/m3 ose 2.6457 Lekë/kWh

Ky vendim do të jetë objekt rishikimi mbas kryerjes së vlerësimit të elementëve të të ardhurave të kërkuara të OSSH sh.a. ERE do të kryejë transferimin e kostove të shpërndarjes së energjisë elektrike të çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

BULETINI INFORMATIV

DHJETOR

2025

Lista e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2026

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 323, datë 15.12.2025 vendosi mbi tarifat e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2026.

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e Tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Vjetore	10,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun e Ditës në Avancë	Vjetore	14,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	7,000 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	3,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun e Ditës në Avancë	Ditore	0.09 €/MWh	Anëtar i Klerimit
Tarifa Teknike	Vjetore	2,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	Transaksion	0.02 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Tregtimit në emër të dikujt tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtar i Bursës
Tarifa për API përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtar i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa e Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata digjitale për Përdorues	Vjetore	50 €	Anëtar i Bursës/Anëtar i
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Vjetore	8,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.14 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.04 €	Anëtar i Bursës

Alpex sh.a. ndodhet në procesin e ndarjes së llogarive sipas aktivitetit, në përputhje me metodologjinë përkatëse. Megjithatë, për shkak të operacioneve të kufizuara si NEMO, u vlerësua e nevojshme që aktiviteti të vijojë edhe për vitin 2026 me tarifat ekzistuese, të miratuara me vendimin nr. 299, datë 30.12.2024 të Bordit të ERE-s. Këto tarifa do të zbatohen deri në përzgjedhjen e Operatorit të ri të Emëruar të Tregut të Energjisë, periudhë që do të shërbejë gjithashtu për krijimin e historikut të nevojshëm të të ardhurave dhe kostove, në funksion të vlerësimit të treguesve ekonomikë dhe financiarë të aktivitetit të NEMO-s, në përputhje me metodologjinë dhe legjislacionin në fuqi.

Tarifa e përkoshme e transmetimit të gazit natyror

Për të garantuar vijimësinë e aktivitetit dhe aksesin në rrjetin e transmetimit, në mbledhjen e datës 12.12.2025 Bordi i ERE-s me vendimin nr. 313 vendosi mbi lënien në fuqi për vitin 2026 të tarifës së transmetimit të gazit natyror prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kWh miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, edhe për vitin 2026.

Për më shumë informacion

Ftojme të gjithë të interesuarit të vizitojnë faqen tonë zyrtare për të shfletuar të gjitha vendimet, raportet, çmimet dhe publikimet më të fundit: www.ere.gov.al